



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlasne

Nr. -1-73

Data

19.05.2021

Br.

Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt.26.05.2021, (e mërkurë) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për faljen e tarifave vjetore të bizneseve private për vitin 2021
4. Dhënia në debat publik e Draft Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike
5. Shqyrtimi i raportit të Komisionit komunal për dhënien e pronave komunale
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme



Kryesuesi i KPF


Burim Gërguri



Dalës-Izlazna

Nr. -1-74
Sr.

Data 19.05.2021
Datum

OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq-Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.27.04.2021, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Burim Gërguri, Florije Jashari, Fatmir Bekteshi, Hysni Mjeku, Qendresa Dubova, Linda Sadiku dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: drejtorët komunal, dhe përf. i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kalu
3. Shqyrtimi i Projekt Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës
4. Raporti i shpenzimeve për periudhën Janar – Mars 2021
5. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës nr.-II-311, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me atë private të Hashim Rifat Berishës, ZK, Bakshi
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Miratohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

Pika e 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Komitetit ishin të pranishëm.

Pika e 2 e rendit të ditës

Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Pika e 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Ju e dini se Projekt Rregullorja për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës, qysh në vitin e kaluar ka dalë në debat publik dhe është një Rregullore unike në nivel të vendit, por për shkak të rrethanave të pandemisë është zvarritë dhe tash në këtë muaj e kemi para vetes. Me datën 16.04, Draft Rregullorja ka qenë në debat publik, është mbajtur procesverbali dhe 12 vetë, kanë qenë prezentë. Kjo Draft Rregullore i ka 44 nene, në 3 kapituj kryesor, që besoj se kujdes i veçantë i është kushtuar trajtimit të çështjes së fëmijëve, do të thotë përkujdesja dhe mbrojtja e fëmijës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimitisht ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim Draft Rregulloren për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – E falenderoj drejtoreshën e financave, e cila çdo herë sipas planit të punës na i sjellë dokumentet, që është për me vlerësue përgjegjësinë e saj në raport me të hyrat, obligimet dhe shpenzimet e Komunës së Obiliqit. Tani, për një sqarim më të gjerë të raportit të shpenzimeve për periudhën Janar – Mars 2021, fjalën ia japë drejtoreshës së DEFZH-së.

Zarife Behluli - Paraqet raportin e shpenzimeve për periudhën Janar – Mars 2021 dhe atë:

Të hyrat vetanake, planifikim janë 950,180.00 €, ndërsa realizim janë 168,871.03 €.

Paga dhe medijtje janë 1,101,667.49 €, të shpenzuara, mallra dhe shërbime të alokuara janë 238,874.98 €, ndërsa të shpenzuara 173,902.37 €.

Shpenzimet komunale, alokim janë 72,750.00 ndërsa shpenzim janë 48,736.12.

Subvencionet dhe transferet të alokuara, janë 162,190.81 €, ndërsa shpenzimi është 47,250.00 € .

Te investimet kapitale, të alokuara janë 4,726,958 €, ndërsa shpenzim janë 204,507.16 €, në zotim janë 1,326,602.16 €.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim raportin e shpenzimeve për periudhën Janar – Mars 2021.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet shqyrtimin e Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës nr.-II-311, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me atë private të Hashim Rifat Berishës, ZK, Bakshi.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës, nr.-II-311, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me atë private të Hashim Rifat Berishës, ZK Bakshi.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga Rruzhdhi Mirena, nga banorët e lagjes Mirena, Hade e Re për rregullimin e energjisë elektrike, rrugës dhe kanalizimin.

Kjo kërkesë shkon për shqyrtim në DSHPE dhe në Zyren e Kryetarit të Komunës.

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga Kastrioti Sh.p.k.për ndihmë financiare për shkak të pandemisë Covid 19.

Fatmir Bektashi - Ne pajisemi me orar prej Komunës dhe ne nuk paguajmë kurgjë ndërsa ata paguajnë 1 euro për km.

Kjo kërkesë shkon për shqyrtim në Zyren e Kryetarit të Komunës dhe në DSHPE.

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga DPUKP-ja, për banorët e Hades së Re, për dhënien e lejes ndërtimore për objekt banimi, podrum dhe garazhë,

Naim Miftari – Ne përderisa jemi në shërbim të qytetarëve jemi munduar të bëjmë të pamundurën që të ia përmirësojmë jetën qytetarëve. Kjo kërkesë është e bazuar në kontratën e lidhur në mes të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe Komunës së Obiliqit, që sipas kësaj kontrate lokacioni Hade e Re, Shkabaj i jepet në menaxhim administrativ Komunës së Obiliqit. Po ashtu, edhe kërkesën e mëhershme lidhur me problematikën e energjisë elektrike do ta adresoj në KEDS, në mënyrë që kjo kërkesë të gjejë zbatim.Ndërsa, kërkesa për banorët e Hades së Re, bëhet fjalë për dhënien e lejeve ndërtimore për ato shtëpi të cilat do të ndërtohen me podrum dhe garazhë. Ne deri më sot këta banorë nuk kemi mund ti pajisim me leje ndërtimore dhe ndaj tyre është bërë e padrejtë, por shpresojmë se kjo është rruga që ne do ta ndjekum në mënyrë që edhe këta banorë ta gëzojnë edhe këtë të drejtë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesën e DPUKP-së për banorët e Hades së Re, për dhënien e lejes ndërtimore për objekt banimi, podrum dhe garazhë, sipas kërkesës së qytetarëve.

Pika 7 e rendit të ditës

Fatmir Bektashi - Unë e kam një kërkesë prej Komisioniut për dhënien e banesave në shfrytëzim, është një vendimi i Kuvendit komunal për pagesën e çdo Komisioni, por pagesa nuk po bëhet ndaj asnjë anëtari të Komisionit. Unë kam qenë te drejtoresha e financave dhe arsyeja është një nen i veçantë që thotë kur të nxjerret ai vendim vetëm për shpeztari nëse, nuk gaboje.Tani, ne çka duhet të bëjmë me ndërrue atë nen, që njerëzve të ua bëjmë pagesën.

Kryesuesi – Unë e di se e keni bërë një punë të jashtëzakonshme si Komision dhe në emër të Kuvendit, ju falenderoj. Unë kërkoj nga drejtoresha e financave, që të vazhdoj me procedura dhe të kryhen obligimet sipas vendimit të Kuvendit komunal. Ju, keni punuar 3 muaj ditë me stres, me ofendim dhe kërcënim për me krye një obligim të punëve, që i keni marrë dhe obligohet Drejtoria e financave, me zbatue vendimin e Kuvendit komunal..

Tani, ju njoftoj se ka ardhë kërkesa nga Ministria përkatëse për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. –I-344, të dt.30.11.2020, të Kuvendit komunal për vlerën e shujtës ditore nga 2.50 euro, në 2.00 euro.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimitisht ia rekomanduan Kuvendit Komunal ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. –I-344, të dt.30.11.2020, të Kuvendit komunal për vlerën e shujtës ditore nga 2.50 euro, në 2.00 euro, për S herbyesit Civil të punësuar në administratën e Komunës së Obiliqit.

Mbledhja përfundoi në ora 10:50'

Bashk. prof. për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesi i KPF


Burim Gërguri